



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:153506  
Datë: 30.08.2022  
Numri i dokumentit: 03374557

C.nr. 1039/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gillogjani, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, në çështjen juridike të paditëses F. P. nga fshati . . ., komuna e Gjakovës, përfaqësuar nga Dardan Morina avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale Arsimit, kontest pune - kompensim të diferencës në paga mujore, vlera kontestit 1,640.40 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 04 gusht 2022, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurës, përpiluar më datë 30 gusht 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses F. P. nga fshati . . ., komuna e Gjakovës, në emër të kompensimit të diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit për periudhën 13 korrik 2018 deri me 31 dhjetor 2020 për gjithsejtë 30 muaj të ia kompensoi shumën prej 1,640.50 euro për 30 muaj dhe atë për secilin muaj shumën nga 54.68 euro, 27% të pagës bazë duke llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në nivel vjetor e cila rrjedh nga data 04 korrik 2022 e deri në pagesën definitive, si dhe të ia kompensoi shpenzimet procedurale në shumë të tërësishme prej 366.80 euro, e që krejt këto të ia paguaj në afat prej 7 ditësh na dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me padi, parashtrësë dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar se është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse në Institucionin Arsimor SHFMU “Dëshmorët Lleshi”, në fshatin . . ., komuna e Gjakovës, ku e njëjta ka punuar dhe vazhdon të punoi në këtë institucion. Duke e llogaritur periudhën kohore prej datës 13 korrik 2018 deri me 31 dhjetor 2020 paditëses për 30 muaj i ka takuar e drejta e kompensimit për 27 % të pagës bazë, në bazë të nivelit të shkollimit, kjo bazuar në Kontratën Kolektive të arsimit të Kosovës të datës 18 prill 2017 po që gjer me tani nuk është kompensuar. Sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1.3 përcaktohet kompensimi në vlerën prej 27% të pagës bazë për mësimdhënëses me diplomë fakulteti me sitëm 3 vjeçar dhe 4 vjeçar. Paditësja ka të kryer Fakultetin e edukimit në Universitetin e Prishtinës llogaritur nga data 26 dhjetor 2012 deri me 26 dhjetor 2017 është licencuar si mësimdhënëse nga MASHT dhe referuar faktit se është e licencuar i takon e drejta në 27% mbi pagën bazë. Paditësja referuar listës së pagave për nivelin e shkollimit dhe referuar licencimit është kompensuar nga e paditura në shumën prej 58.32 euro nga shuma që është dashur të paguhej prej 113.67 euro, andaj bazuar në të lartcekurat ka bërë edhe precizimin e kërkesë padisë në shumën e përgjithshme 1,640.40 euro për 30.00 muaj dhe atë për secilin muaj shumën nga 54.68

euro apo 27% të pagës bazë duke minusuar pjesën e paguar në shumën prej 58.32 euro sepse e njëjta shumë është paguar nga e paditura.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka deklaruar se pas administrimit të provave është vërtetuar në tërësi baza dhe lartësia e kërkesë padisë, po ashtu është vërtetuar fakti se e paditura nuk e ka paguar në tërësi diferencën në pagë duke ju referuar bazës së kualifikimit dhe licencimit. Është vërtetuar fakti se paditësja për periudhën kohore sipas kërkesë padisë ka qenë e licencuar edhe përkundër faktit se licenca e dorëzuar dhe administruar si provë ka datën e skadimit 26 dhjetor 2017, lidhur me vazhdimin e licencimit për paditësen në fjalë edhe për 5 vitet e ardhshme nga viti 2017 është rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr.5/2017 dhe ka propozuar që kërkesë padia e precizuar të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro , për taksë për padi 61.00euro për një seancë gjyqësorë të shtyrë shumën prej 67.60euro (apo 50% të tarifës prej 135.20€) dhe për një seancë të plotë shumën 135.20 euro, gjithsejtë shumën prej 367.80euro.

E paditura ka paraqit përgjigje në padi me të cilën ka parashtruar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar në mes të MASH me datë 22 janar 2021 në nenin 47 të saj ka shfuqizuar Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë në mes MASHT dhe SBASHK numër 01B/2556 datë 18 prill 2017 ashtu që në nenin 7 të Kontratës Kolektive citim” Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës dhe mbi bazë e licencës së fituar bazuar në Udhëzimin administrativ numër 5/2017. Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale si vijon: mësimdhënëse me licencë të karrierës 10% e pagës bazë, mësimdhënëse me licencë mentor 15% e pagës bazë, por lidhur me këtë dispozitat kalimtare të paraparë me nenin 45 paragrafi 1 citim: “ MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostove financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafi 5,7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në Buxhetin e Republikës së Kosovës por jo me vonë se viti 2023, sipas Qarkores buxhetore 22/01 të datës 14 maj 2021 të lëshuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve . Sipas nenit 87 të Ligjit të punës të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa e palës paditëse.

Shqyrtimin përgatitor - kryesor të caktuar më datë 04 gusht 2022, Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt që vërtetohet sipas fletë kthesës së Gjykatës e cila nga e paditura është pranuar me datë 25 korrik 2022 dhe me propozimin e të autorizuarit të paditëses, sipas nenit 409.2 dhe 423.4 të LPK-së, është

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave: Kontratës së punës datë 01 shtator 2015 Leg.nr.2071/21 datë 16 qershor 2021, Vërtetimi mbi muajt e punës nr.152/21 datë 18 qershor 2021, Diplomës nr.288 datë 14 prill 2015 LRP.nr.6141/22 datë 23 maj 2022, Licencës së mësimdhënësës nr.100008838 datë 26 dhjetor 2017 dhe listës së pagave për muajin dhjetor 2020.

Nga Kontrata e punës e datës 01 shtator 2015 vërtetohet se paditësja në cilësinë e mësimdhënësës në cilin klasor shkollën “Dëshmorët Lleshi” fshati . . , Komuna e Gjakovës me kualifikimin Bachelor Program Fillor ka lidhë kontratë të përhershme të punës. Paditësja posedon Diplomë të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë me numër të protokollit

288 e datës 14 prill 2015 dhe ka marrë titullin Bachelor i programit fillor. Padiësja posedon vërtetimin mbi muajt e punës me nr.152/21 të datës 18 qershor 2021 me të cilën vërtetohet se është mësimdhënëse në Institucionin Arsimor SHFMU “Dëshmorët Lleshi” në . . . dhe ku e ka titullin si mësimdhënëse dhe për periudhën kohore nga data 18prill 2017 deri me datë 31 dhjetor 2020 ka gjithsej 44 muaj punë. Me licencën e mësimdhënësit me numër 100008838 e lëshuar me date 26 dhjetor 2012 deri me datë 26 dhjetor 2017, me të cilën vërtetohet se padiësja është licencuar për periudhë pesë vjeçare me licencë të karrierës. Nga lista e pagave e muajit dhjetor 2020, vërtetohet se padiësja F. P. është në cilësi të mësimdhënëses në atë shkollën, ka tridhjetë e katër vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 489.15 euro, dhe ka realizuar shtesën për kualifikim me fakulteti në shumë prej 58.32 euro.

Lidhur me kompensimin gjegjësisht diferencën e kompensimit në paga mujore që ka realizuar padiësja Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 7 pika 1. të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18 prill 2017 sipas të cilës dispozitë përcaktohet se: ”Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë pika 1.3 mësimdhënëse me diplomë fakulteti tre dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë andaj bazuar dhe në provat e lartcekura përkatësisht në diplomën numër 288 e datës 14 prill 2015 me të cilin padiësja ka fituar titullin bachelor i programit fillor, Aktvendimi mbi licencën me numër 100008838 me të cilën vërtetohet rrethana se padiësja posedon licencën e mësimdhënëses të vlefshme nga data 26 dhjetor 2012 deri me 26 dhjetor 2017, ashtu që bazuar në UA nr.5/2017 sistemi i licencimit në zhvillim të mësimdhënësve në karrierë i MASHT sipas nenit 33 paragrafi 1 pika 1 “ Vazhdohen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, Licencat e lëshuara në këto vite mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të VPM (Vlerësimi profesional i mësimdhënësve). Hyrja në fuqi e Kontratës së Arsimit nga datë 18 prill 2017 deri me datën 22 janar 2021 ka qenë në fuqi dhe padiësja i takon e drejta për një kompensim të tillë.

Bazuar në listën e pagës të administruar gjatë shqyrtimit vërtetohet se padiësja ka realizuar pagën bazë 421.00 euro për periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e që duke llogaritur me 27% del të jetë shuma prej 113.67 euro nga duhet zbritur shtesën 58.32 euro që ka realizuar, e që ka mbetur pa u realizuar shuma prej 54.68 euro për 30 muaj, pra  $30 \times 54.68 = 1,640.40$  euro. Neni 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parasheh se i punësuar ka të drejtën në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit çka rezulton se e paditura nuk i është përmbajtur Kontratës së punës dhe akteve administrative të cilat janë të zbatueshme që rezulton me pagesën e detyrimit padiësja.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënëse dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e pagesës së diferencës në paga nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e padiësja dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës(LMD) është paraparë se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Dispozita e nenit 245 paragrafi 1 i LMD-së ka paraparë se :”Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtje e tij”, prej nga rezulton se debitori këtu e paditura është e detyruar që kreditorit, këtu paditësit të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë së aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

Lidhur me kamatën Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të LMD-së , ku parashihet se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton , përpos borxhit kryesor dhe kamatën. Paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditëses i takon edhe kamata e gjykuar sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, nuk ka vendosur lidhur me kompensimin e diferencës në pagë për periudhën nga 18 prill 2017 e deri me 13 korrik 2018 ngase i autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 04 gusht 2022 ka bërë precizimin e kërkesë padisë duke mos përfshirë periudhën e cekur sepse e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës për periudhën në fjalë.

Gjykata në procedure bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse në arsyetimin e Aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar si dhe aplikimin e të drejtës materiale në marrjen e vendimit si më lartë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë bazuar në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumën 60.00 euro, për përpilim të padisë shumën 104.00 euro për një seance gjyqësore të shtyrë shumën prej 67.60 euro (apo 50% të tarifës prej 135.20) dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditësit në një seancë në shumë 135.20 euro, në shumë të tërësishme 366.80 euro.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
C.nr. 1039/21, datë 30 gusht 2022

G j y q t a r j a  
Afijete Sada Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatë